 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të

rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>		<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1	Platforme e sigurte per nderveprimin mes software-ve inxhinierike per projektim/kontroll	Set	1			
2	Instalim software dhe licencim (3 vjecar) per software inxhinerik per projektimin/kontrollin e linjave elektrike te tensionit te larte	Set	2			
3	Instalim software dhe licencim (3 vjecar) per software inxhinerik per projektimin/kontrollin e shtyllave metalike te rrjetezuara	Set	2			
4	Instalim software dhe licencim (3 vjecar) per software inxhinerik per projektimin/kontroll nenstacioneve elektrike	Set	2			
5	Instalim software dhe licencim (3 vjecar) per software inxhinerik per perpunime grafike	Set	8			

6	Instalim software dhe licencim (3 vjecar) per software inxhinerik per analizimin, planifikimin, optimizimin dhe simulimin e rrjeteve elektrik	Set	1			
7	Trajnim per software-in e linjave elektrike te tensionit te larte dhe shtyllave metalike te rrjetezuara per 2(dy) specialiste	Komplet	1			
8	Trajnim per software-in e nenstacioneve elektrike per 2(dy) specialiste	Komplet	1			
9	Mirembajtja e programeve inxhinierike (softeve), per 3 vjet	Komplet	1			
Çmimi total (Mallrat)						_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Licencimi, mirëmbajtjen dhe trajnimin e programeve inxhinierike në OST sh.a.”

Afatet e ekzekutimit:

1	Licencimi fillestar			6 muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates
2	Trajnimi per programet e instaluara			6 muaj nga instalimi dhe pranimi i licencimit fillestar
3	Mirëmbajtja e programeve inxhinierike (softeve)			36 muaj nga instalimi dhe konfigurimi

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Qëllimi

Me qëllim mbulimin e detyrave funksionale të Sektorit të Projekteve në OST sh.a. kërkohet një listë software-sh inxhinierike të cilat kanë si fokus aktivitetet kryesore të OST sh.a. Aktualisht kontrolli i projekteve kryhet manualisht ose me software të vjetra të cilat nuk suportohen më nga prodhuesit e tyre. Ky fakt vështirëson kontrollin e projekteve të reja të cilët janë punuar me versionet e fundit duke kufizuar kontrollin në paraqitjen grafike dhe raportet e gjeneruara.

Objekti

Për të rritur cilësinë e punës së Sektorit të Projekteve në OST sh.a. kërkohet:

1. Platforme e sigurte per nderveprim mes software-ve inxhinierik per projektim/kontroll
2. Software inxhinierik për projektimin/kontrollin e linjave elektrike te tensionit te larte
3. Software inxhinierik për projektimin/kontrollin e shtyllave metalike të rrjetëzuara
4. Software inxhinierik për projektimi/kontrollin e nënstacioneve elektrike
5. Software inxhinierik për përpunime grafike
6. Software inxhinierik per analizimin, planifikimin, optimizimin dhe simulimin e rrjeteve elektrike
7. Trajnime për përdorimin e software-eve

Specifikimet e software-ve, sasitë dhe funksionet jepen në vijim.

Kërkesat teknike

PLATFORME E SIGURTE PER NDERVEPRIMIN MES SOFTWAREVE INXHINIERIKE PER PROJEKTIM/KONTROLL

Platforma e sigurte per projektimin dhe kontrollin e linjave elektrike te tensionit te larte duhet te kete karakteristikat e meposhtme:

- Te jete e aksesueshme ne menyre te sigurte, me autentikim te dyfishte nga perdoruesit e softwareve inxhinierike per projektim/kontroll nga nje browser web ose aplikacion i dedikuar lokal.
- Perdoruesi te kete mundesi te aksesojë/ndaje dokumentat nderveprues, mes softwareve te ndryshem.

-
- Te perdore nderfaqe grafike perdoruesi te thjeshte dhe te lehte per tu kuptuar.
 - Te kete mundesi te shkarkoje raporte dhe dokumente inxhinierike te formateve te ndryshem.
 - Te ruaje log te aktivitetit te perdoruesve per cdo veprim ne platforme.
 - Te kete mundesi organizimi te arkives dhe aksesit sipas logjikes se punes.
 - Te kete backup inkremental te te gjithë arkives.

SOFTWARE INXHINIERIK PER PROJEKTIMIN/KONTROLLIN E LINJAVE ELEKTRIKE TË TENSIONIT TË LARTË

Software inxhinierik për projektimin dhe kontrollin e linjave elektrike te tensionit te larte duhet te kete karakteristikat e meposhtme:

- Të ekzekutohet dhe operojë në sistem operativ Windows 10 dhe Windows 11 64-bit
- I përshtatshëm për operim optimal në makina me procesor Gjenerata e 8 dhe lart.
- Karte grafike e integruar, RAM 8GB dhe hapësire HDD 500GB ose ekuivalente.
- Të përdorë ndërfaqe grafike përdoruesi të thjeshtë dhe të lehte per tu kuptuar.
- Të printojë raporte dhe dokumenta te tjera, direkt në një shumëllojshmëri të gjerë printerësh dhe ploterësh.

Të krijojë një modelim terreni 3-dimensional (përfshirë trekëndëshimin automatik të TIN) që lejon:

- Zgjedhjen e traseses duke klikuar në pikat e këndit të linjës
- Levizjen lehtësisht te pozicionimit te strukturave në plan ose të profilin e linjës
- Krijimin automatik të profileve qendrore ose anësore të linjës
- Identifikimin e çdo kategori të vecantë të terrenit me një kod dhe simbol unik sipas veçorive
- Percaktimin automatik të vijës se kërkuar të distancës së lejuar vertikale për çdo tension të specifikuar
- Paraqitjen e terrenit me ngjyrë sipas kuotës dhe shkallës së dritës
- Importimin e të dhënave për terrenin nga GPS, fotogrametria ose pajisjet topografike të stacionit total
- Parametrat meteorologjikë me rregullime individuale të erës, akullit, temperaturës sipas kërkesave te standardeve europiane dhe boterore
- Faktorët e sigurisë për kontrollin e forcave në struktura
- Ngarkesën në tela (Fillestare, pas Varjes ne kohë ose pas Ngarkesës Ekstreme).

Të ketë një model 3-dimensional të linjës që ben te mundur të:

-
- Paraqiten të gjitha strukturat me të gjithë telat dhe izolatorët
 - Zgjidhen strukturat dhe telat nga librarite e redaktueshme nga përdoruesi
 - Pozicionohen strukturat në linjë në mënyrë interaktive ose automatike (optimizimi global i kostove)
 - Varen telat në linjë në mënyrë interaktive ose automatike
 - Kryen çdo llogaritje të varjes dhe tensionit të telave, duke përfshirë efektin e varjes së tyre nga koha
 - Zgjidhen modele të ndryshme përcjellsish për të përfaqësuar më mirë sjelljen në temperaturë të lartë
 - Përcaktohet pema e ngarkesës sipas kritereve të projektimit
 - Llogariten hapësirat vertikale ose horizontale nga toka ose objektet për çdo përcjells
 - Kontrollonjë qëndrueshmërinë e strukturës me metodat e kampatave të lejuara të erës dhe peshës
 - Kontrollonjë qëndrueshmërinë e strukturës në mënyrë interaktive me programet e analizës strukturale
 - Kontrollonjë hapësirat e lejuara elektrike ndërmjet përcjellsve dhe strukturave
 - Vizualizonjë linjën në 3 dimensione me fryrjen aktuale të erës dhe pjerrtesinë e izolatorëve

Një sistem grafik që bën të mundur të:

- Gjenerojë automatikisht fletët e planit dhe profilit;
- Kontrollonjë shkallën e vizatimit dhe paraqitjen e faqeve;
- Eksportojë fletët e planit dhe profilit në PDF;
- Mbivendosë fotografitë ajrore ose hartat në plan;
- Dixhitalizojë vizatimet e planimetrisë dhe profileve të skanuara.

Një sistem i menaxhimit të materialit që bën të mundur të:

- Importojë pjesë, nyje dhe njësi pune nga bazat e të dhënave ekzistuese;
- Gjenerojë automatikisht kostot e strukturës për optimizim;
- Gjenerojë automatikisht listat e materialeve për ndërtim.

SOFTWARE INXHINIERIK PËR PROJEKTIMIN DHE KONTROLLIN E SHTYLLAVE METALIKE TË RRJETËZUARA

Software inxhinierik për projektimin dhe kontrollin e shtyllave metalike të rrjetëzuara duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Të ekzekutohet dhe operojë në sistem operativ Windows 10 dhe Windows 11 64-bit
- I përshtatshëm për operim optimal në makina me procesor Gjenerata 8 dhe lart, Karte Grafike e integruar, RAM 8GB, HDD 500GB, ose ekuivalente.
- Lehtësi në vendosjen e të dhënave përmes menuve interaktive;
- Mundësia për analizë lineare dhe jolineare me elementë të fundëm;
- Databaza të eleve metalike, te rrumbullakta, bulonave etj.;
- Gjenerim automatik të nyjeve dhe elementëve në mënyrë simetrike dhe me interpolime;
- Elet e çelikut mund të modelohen si trarë, kapriata apo element tensionues;
- Menaxhim automatik i elementëve tensionues;
- Shpërndarje automatike e ngarkesave në izolatorët varës me dy përbërës (v-strings, etc.);
- Llogaritja automatike e ngarkesës së shtyllës, akullit dhe erës si dhe të koeficientit tërheqës sipas standardeve të mëposhtëm:
 - ASCE 74-1991, 2009
 - NESC 2002, 2007, 2012, 2017
 - IEC 60826:2003, 2017
 - IS 802: 1995, 2015
 - ISEC-NCR-83
 - EN50341-1:2001 and 2012 (CENELEC)
 - EN50341-3-2:2001 (Belgium NNA)
 - EN50341-3-9:2001, EN50341-2-9:2015, 2017 (UK NNA)
 - EN50341-3-17:2001 (Portugal NNA)
 - EN50341-2-22:2016 (Poland NNA)
 - AS/NZS 7000:2010, 2016
 - ESAA C(b)1-2003 (Austalia)
 - TPNZ (New Zealand)
 - REE (Spain)
 - SP 16.13330.2011 (SNiP Russia)

-
- Minimizimi i problemeve të shkaktuara nga nyjet e paqëndrueshme;
 - Analiza dhe kontrolli i dizajnit sipas:
 - ASCE 10
 - AS 3995 (Australian Standard 3995)
 - BS 8100 (British Standard 8100)
 - EN50341-1 2001 and 2012 (CENELEC, të dy metodat empirike dhe analitike janë të mundshme)
 - EN50341-2-9:2015, 2017 (UK NNA)
 - ECCS 1985
 - NGT-ECCS
 - PN-90/B-03200
 - EN50341-2-22:2016 (Poland NNA)
 - SP 16.13330.2011 (SNiP Russia)
 - EDF/RTE Resal
 - IS 802 (India Standard 802)
 - Përmbledhje të raporteve për çdo grup elementësh;
 - Përmbledhje të raporteve lehtësisht të interpretueshme në tekst, tabela dhe grafikë;
 - Përcaktimin automatik të kmpatave të lejuara të erës dhe peshës;
 - Përcaktimin automatik të diagramës intraktive ndërmjet kmpatave të lejuara të erës dhe peshës;
 - Zgjedhje optimale automatike e përmasave të eleve dhe përcaktim i llojit dhe sasisë të bulonave;
 - Mundësi interaktive për përmasim të eleve dhe përcaktim të llojit dhe sasisë të bulonave;
 - Mundësi për të modeluar zhvendosjen e bazamenteve;
 - Manual i detajuar përdoruesi me shembuj;
 - Faqe përdoruesi të vlefshme në Anglisht
 - Sistem Imperial ose SI (metrik) njësisish;
 - Modul të fuqishëm grafik (sforcimi i treguar me ngjyra të ndryshme)
 - Perzgjedhje grafike e nyjeve dhe elementëve që lejon modifikim dhe kontroll grafik;

-
- Shtyllat mund të paraqiten si konture ose si sipërfaqe poligonale 3-d;

SOFTWARE INXHINIERIK PËR PROJEKTIM/KONTROLL TE NËNSTACIONEVE ELEKTRIKE

Me qëllim realizimin e projekteve ose rikonstruksionin e nënstacioneve kërkohet software kompjuterik i specifik për projektimin e nënstacioneve elektrik me funksione të shumta me aftësi përpunimi në 2D dhe 3D.

Software-i duhet të krijojë në mënyre automatike listën e materialeve si dhe duhet të kontrollojë në mënyre automatike distancat e sigurisë.

Objektet e përfshira në projekt duhet të jenë të lidhura me bazën e të dhënave të software-it. Pas realizimit të lidhjeve të pajisjeve në momentin e ripozicionimit të një pajisje atëherë duhet të ripozicionohet i gjithë grupi. Ndërfaqja dinamike duhet të shfaqë në mënyre automatike modifikimet në 2D dhe 3D.

Software-i duhet të ketë aftësi për të projektuar ose analizuar sistemin e tokëzimit, sistemin e mbrojtjes nga rrufetë, shigjetën e varjes së përcjellëseve.

Puna duhet të jetë e organizuar në bazë projekti me qëllim ndërlidhjen e disa pjesëve të ndryshme të projektit me qëllim që ndryshimet e bëra në një pjesë e projektit të reflektohen menjëherë në pjesën tjetër të projektit.

Software-i duhet të njoftojë në mënyre automatike në rast gabimesh, me qëllim reduktimin në minimum kontrollin manual të projektit.

Software duhet të krijojë në mënyre automatike dokumentacionin e projektit të lidhura me skemën e ndërtuar të nënstacionit.

Karakteristikat kryesore:

- Të ekzekutohet dhe operojë në sistem operativ Windows 10 dhe Windows 11 64-bit
- I përshtatshëm për operim optimal në makine me Processor i3-Gjenerata e 8, Karte Grafike e integruar, RAM 8GB, HDD 500 GB, ose ekuivalente
- Objekte të lidhura me bazën e të dhënave të pjesëve
- Pikat e fiksimit rreshtohen automatikisht dhe bashkohen me objekte të lidhura
- Aftësia e Kontrollit projektimit të sistemit të tokëzimit
- Algoritmi i llogaritjes së përcjellësit (spline and catenary, hook-point enabled)
- Mbrojtja nga mbritensionet atmosferike (metoda e sferës rrotulluese)
- Pamjet dinamike – 2D dhe 3D të cilat përditësohen në mënyrë dinamike kur njëra prej tyre modifikohet
- Pamjet dinamike të seksioneve

Veçoritë e vizatimit / projektimit elektrike

- Organizimi i projektimit të bazuar në projekte
- Katalogu i simboleve elektrike ANSI/IEEE ose IEC i përfshirë
- Bazat e të dhënave të pjesëve të prodhuesve dhe katalogët e simboleve

-
- Aftësia e gjetjes/zëvendësimit të përcjellësve
 - Formatet e etiketave të pajisjes të përcaktuara nga përdoruesi
 - Shtrirja e përcjellësve dhe formatet e etiketave të përcaktuara nga përdoruesi
 - Diagramet e terminaleve të kablllove
 - Modelim i paraqitjes së paneleve
 - Rreshtimi automatik i komponentëve
 - Gjen/zëvendëson simbolet dhe vetitë e simboleve
 - Kopjimi automatik i projektit
 - Kopjon, riemërton, zhvendos faqen
 - Etiketimi automatik i pajisjes
 - Krijimi i simboleve në mënyrë manuale
 - Aftësia e migrimit të simboleve
 - Shfaqja e vetive të telit të përcaktuar nga përdoruesi
 - Menaxhim i katalogut
 - Menaxhim i kablllove
 - Gjenerim skematik i PLC
 - Adresim automatik i PLC
 - Rrotullimi i automatizuar i simboleve
 - Referenca të kryqëzuar në kohë reale nëpër faqe të shumta
 - Aftësi të shumta për zhbërje/ribërje (undo/redo)
 - Kontroll i menjëhershëm i gabimeve në kohë reale
 - Përcaktim i detyruar i trasesë së kablllove
 - Diagramet dinamike të kablllove
 - Importoni grafikë simbolesh nga shitësit e palëve të treta
 - Përcaktim i distancë më të shkurtër për kabllot

Raportet dhe Dokumentacioni

- Gjenerimi automatik i raporteve
- Lista e materialeve
- Lista e kablllove
- Etiketimet e kablllove
- Raportet e llogaritjes së gjatësisë së kablllove
- Lista e kablllove
- Raporti i kostos së punës
- Raporte sipas nevojës së përdoruesit
- Formatet e raportit TXT, CSV, HTML, RTF, PDF, XLS, MHT
- Botuesi i projektit

SOFTWARE INXHINIERIK PËR PËRPUNIME GRAFIKE

Software inxhinierik për përpunime grafike duhet të ketë funksionalitetet e mëposhtme:

-
- Të ekzekutohet dhe operojë në sistem operativ Windows 10 dhe Windows 11 64-bit
 - I përshtatshëm për operim optimal në makina me procesor Gjenerata 8 dhe lart, Kartë Grafike e integruar, RAM 8GB, HDD 500GB ose ekuivalente.
 - Modelimi dhe vizualizimi 3D
 - Renderim fotorealistik
 - Modelimi i ngurtë, sipërfaqësor dhe rrjetë
 - Stilet e paraqitjes
 - PDF dhe DGN Import/Eksport/Underlay
 - Planet e seksionit
 - Skanimi 3D dhe pika 3D
 - Navigacion 3D
 - Pamjet bazë, të projektuara dhe të seksionit
 - Cilësimet e tekstit
 - Nxjerrja e të dhënave
 - Lidhja e të dhënave
 - Dimensionimi i zgjuar
 - Paraqitjet (Layouts)
 - Layout Viewports
 - Liderët
 - Mjetet për modifikim të shpejtë (Express Tools)
 - Tabelat
 - Fushat
 - Kufizimet parametrike
 - Retë e rishikimit
 - Bashkëpunimi
 - Importoni modele 3D
 - Menaxheri i grupeve të fletëve
 - Modelet e referencës Navisworks
 - Ndërveprimi i përdoruesit
 - Paletat e mjeteve
 - Blloqe dinamike
 - Hartimi 2D, Vizatimi dhe Shënimi
 - Linja e komandës
 - Instalimi dhe personalizimi
 - Përzgjedhja dhe izolimi i objekteve
 - Kapje multifunktionale
 - Vendndodhja gjeografike dhe hartat në internet
 - Mundësi punimi me numër të madhë vijash me karakteristika të ndryshme

**SOFTWARE INXHINIERIK PËR MODELIMIN DHE ANALIZIMIN E SISTEMEVE
ELEKTROENERGJITIKE**

Software inxhinierik per modelimin, analizimin dhe optimizimin e sistemeve elektroenergjitike duhet te kete karakteristikat e meposhtme:

- Te ekzekutohet dhe operoje ne nje sistem operativ Windows 10 dhe Windows 11 64-bit
- I pershtatshem per operim optimal ne makina me procesor Gjenerata 8 dhe lart, karte grafike e integruar, RAM 8GB, HDD 500GB, ose ekuivalente.
- Te jete i afte per te bere modelimin dhe analizimin e sistemeve elektroenergjitike me tension te ulet dhe te mesem.
- Te kete nje databaze te gjere te elementeve te perdorur per modelimin e sistemeve elektroenergjitike.
- Te kete aftesi per te bere analizen e rrjedhes se ngarkeses dhe renies se tensionit.
- Te kete aftesi per te analizuar rrymat e defektit dhe te beje krahasim automatik me vleresimet e prodhuesit.
- Te kete aftesi per te bere simulimin e burimeve te rrymes dhe tensionit harmonik.
- Te kete aftesi per te bere analizen e rrjedhes se ngarkeses DC sipas standarteve nderkombetare si IEEE Standard 946
- Te kete aftesi per te bere modelimin e sistemeve energjitike me skematika te thjeshtuara me nje linje (One Line Diagram)
- Te kete aftesi per modifikimin dhe paraqitjen grafike te analizes se te dhenave te sistemit elektroenergjitik me ane te mjeteve baze si zmadhim, editim, kopjim, emertim automatik te elementeve etj.
- Te beje nje llogaritje te plote te qarkut te shkurter, me detaje te variacioneve te rrymes se defektit ne vendndodhjen e tij, gjithashtu dhe per deget kontribuese, nga fillimi i defektit deri ne fundin e tij.
- Te beje analizen e qarkut te shkurter sipas standarteve nderkombetare ANSI / IEEE C37 & UL 489, IEC 60909, IEC 61363, GOST R-52735
- Te beje llogaritjen e profileve te tensionit të busit dhe flukset e fuqisë së degëzimit si dhe te beje krahasimin e vlerave te llogaritura të funksionimit kundrejt kufijve të tensionit të busit, kapaciteteve të kablllove dhe kapaciteteve të burimit.
- Te beje llogaritjen e tensionit te busit, faktorët e fuqisë së degëzimit, rrymat, humbjet e sistemit, prodhimin e energjisë kundrejt ngarkesës dhe te beje simulimin e tensioneve te kontrollit në të gjithë sistemin.

TRAJNIMI

Trajnimi i personelit te OST për software-t të cilat do të funizohen perkatesisht:

- Trajnim për software e linjave elektrike te tensionit te larte dhe shtyllave metalike të rrjetezuara.

Ky trajnim duhet të fokusohet në përdorimin e software-it për projektimin e linjave të tensionit të lartë nga ekspertë të fushës, të cilët të mbulojnë aspekte të gjera të funksioneve të software-it.

Kohëzgjatja e trajnimit duhet të jetë minimalisht 5 dite kalendarike. Axhenda e trajnimit duhet të miratohet paraprakisht nga OST sh.a.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit duhet të pajisen me certifikatën përkatëse.

- Trajnim për software e nënstacioneve elektrike.

Ky trajnim duhet të fokusohet në përdorimin e software për projektimin e nënstacioneve elektrike duke përdorur software-in përkatës nga ekspertë të fushës, të cilët të mbulojnë aspekte të gjëra të funksioneve të softare-it. Kohëzgjatja e trajnimit duhet të jete minimalisht 5 dite kalendarike. Axhenda e trajnimit duhet të miratohet paraprakisht nga OST sh.a.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit duhet të pajisen me certifikatën përkatëse.

LËVRIMI

Nr	Emërtimi	Njësi	Sasia
1	Platforme e sigurte per nderveprimin mes software-eve inxhinierike per projektim/kontroll	Set	1
2	Instalim software dhe licensim (3 vjecar) per software inxhinierik per projektimin/kontrollin e linjave elektrike te tensionit te larte	Set	2
3	Instalim software dhe licensim (3 vjecar) per software inxhinierik per projektimin/kontrollin e shtyllave metalike te rrjetezuara	Set	2
4	Instalim software dhe licensim (3 vjecar) per software inxhinierik per projektimi/ kontroll nenstacioneve elektrike	Set	2
5	Instalim software dhe licensim (3 vjecar) per software inxhinierik per perpunime grafike	Set	8
6	Instalim software dhe licensim (3 vjecar) per software inxhinierik per analizimin, planifikimin, optimizimin dhe simulimin e rrjeteve elektrik	Set	1
7	Trajnim per software-in e linjave elektrike te tensionit te larte dhe shtyllave metalike te rrjetezuara per 2 (dy) specialiste	Komplet	1
8	Trajnim per software-in e nenstacioneve elektrike per 2 (dy) specialiste	Komplet	1
9	Mirembajtja e prograve inxhinierike (softeve), per 3 vjet	Komplet	1

Shënime:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 98,000,000 (nentedhjetë e tete milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 19,000,000 (nentembedhjete milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të furnizuara.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ✓ **ISO 9001:** për menaxhimin e cilësisë
- ✓ **ISO 27001:** për menaxhimin të sigurisë së informacionit
- ✓ **ISO 20000-1:** për sistemet e menaxhimit të shërbimit

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve jo më të vogël se 10 (dhjete). Te pakten 7 prej tyre duhet të jene te diplomuar ne shkenca elektronike / teknologji informacioni / informatike / informatike ekonomike / mekatronike / telekomunikacion. Punonjësit duhet te disponohen nga Operatori Ekonomik ofertues per nje periudhe prej te pakten 6(gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates dhe te jene te certifikuar si me poshte:*

- ✓ *Per te garantuar nje menaxhim sa me te mire te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) person te certifikuar per Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
- ✓ *Per te garantuar implementimin dhe menaxhimin e sistemeve perfshire implementimin sipas praktikave me te mira te sigurise se informacionit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar per Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve te Sigurise se Informacionit (CISM ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
- ✓ *Per te garantuar implementimin dhe testimin e sistemeve te informacionit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) person te certifikuar si analizues testimi te sistemeve*

(Certified Software Testing Analyst ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.

- ✓ *Per te garantuar implementimin dhe menaxhimin e sistemeve te informacionit, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) person te certifikuar si Menaxher i sistemeve IT (ITIL ose ekuivalent). Certifikimi duhet te vertetohet lehtesisht nga website zyrtar i certifikuesit.*
- ✓ *Per te garantuar autenticitetin dhe disponueshmerine e sistemeve te implementuara te konunikimit dhe ne menaxhimin e disponueshmerine, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2(dy) punonjes te certifikuar per Komunikim ne rrjeta online (CCNA ose ekuivalent).*
- ✓ *Per te garantuar implementimin e sistemeve te informacionit te ofruar, operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si Auditor i Sistemeve te Informacionit (CISA ose ekuivalent).*

Shenim: *Nje punonjes mund te zoteroje me shume se nje certifikim te kerkuar si me siper.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per te gjithë stafin e kerkuar me siper, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: CV-të, listepagesat e-Sig per periudhen e kerkuar, diplomat dhe certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

- 2.3.4 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: *Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
